



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR**

Nr \_\_\_\_\_ prot

Tiranë më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ . 2024

**VENDIM**

**Nr. 731, datë 05.12.2024**

**PËR**

**SHFUQIZIMIN E VENDIMIT NR. 494 DATË 25.10.2021 TË KËSHILLIT TË  
LARTË GJYQËSOR, “PËR PEZULLIMIN E PROCEDIMIT DISIPLINOR, TË  
FILLUAR NDAJ MAGJISTRATËVE, Z. {...} DHE Z. {...}, ME DETYRË  
GJYQTARË PRANË GJYKATËS SË APELIT VLORË” DHE VIJIMIN E  
SHQYRTIMIT TË TIJ**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenet 147 dhe 147/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenet 97 pika 3 dhe 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, në nenin 66, 67, 68 pika 2 të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë,

**VENDOSI:**

1. Shfuqizimin e vendimit nr. 494 datë 25.10.2021 për “Pezullimin e procedimit disiplinor të filluar ndaj magjistratëve z. {...} dhe z. {...}, me detyrë gjyqtarë në Gjykatën e Apelit Vlorë, deri në përfundimin e procedurës së rivlerësimit kalimtar, me vendim të formës së prerë”.
2. Vijimin e shqyrtimit të procedimit disiplinor të filluar ndaj ish magjistratëve z. {...} dhe z. {...}, me detyrë gjyqtarë në Gjykatën e Apelit Vlorë dhe caktimin e seancës dëgjimore me datë 19.12.2024, ora 10.30.
3. Një kopje e vendimit t’i njoftohet z. {...}, z. {...} dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e botimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

**PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**